



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10.3, të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 nën paragrafi (c), nenin 65.2 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2017, për Procedurën e Zëvendësimit të Anëtarit të Kuvendit Komunal, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 28.03.2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Z. NUSRET ÇUBRELI** emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Mitrovicë së Jugut, nga subjekti politik "Aleanca Kosova e Re" AKR" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z. Besnik Beka.
- II. Obligohet Kryesuesi i Kuvendit Komunal në Mitrovicën e Jugut, që ky vendim t'i komunikohet z., **Nusret Cubreli** dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 27.02.2019, Nr.128/2019, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit z. **Besnik Beka**, pas dorëheqjes së tij të parëvokueshme nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Komunës, për arsye të dorëheqjes dhe marrjes së pozitës së drejtorit në Kuvendin Komunal.

Andaj, duke u bazuar në deklaratën e pranimit të mandatit të kandidatit të radhës sipas listës së rirenditur, i cili është, z. Nusret Cubreli nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2017, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 28.03.2019

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve


Valdete Daka